



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 136 dt.28.04.1994

PER
SHPALLJEN DESHMOR TE ATDHEUT Z. ARTIN PERPARIM BASHA

Këshilli i Bashkisë Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.28.04.1994, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Seksioni i Organizimit për Shpalljen “Dëshmor të Atdheut” të të riut Artin Përparim Basha, nxënës në shkollën e Mesme Teknologjike

Vëren se :

Artin Përparim Basha, lindur në Tiranë në Lagjen Nr.6, rritur dhe edukuar nga prindërit e tij punëtorë me ndjenjën e urrejtjes kundër diktaturës Komuniste. Ai merr pjesë aktivisht në Lëvizjen e Rinisë për Demokraci. Duke mos duruar shtypjen e egër të Pushtetit Monisto – Komunist dhe në gjendje të revoltuar tenton të futet në Ambasadën Gjermane. Aty goditet me armë zjarri nga Forcat e Sigurimit të Shtetit Diktatorial dhe më vonë vdes.

Në këto kushte mbështetur në Dekretin e Presidiumit të Kuvendit Popullor Nr.4558, dt.18.10.1969

VENDOSI

1. Të shpalli Dëshmor të Atdheut të riun 17 vjeçar Artin Përparim Basha.

2. Ky vendim hyn në fuqi.menjëherë.

KRYETARI

BESNIK PETRELA